



ODA EKONOMIKE KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVES OF COMMERCE

Prishtinë – 19.10.2023

## ODA EKONOMIKE E KOSOVËS NJOFTIM MBI RUAJTJEN E PRIVATËSISË

### ***SI I PËRDORIM NE INFORMACIONET TUAJA***

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë ju ofron informacionet e nevojshme se cilat janë pritet në mbledhjen e të dhënavë tuaja peronale që konsistonë në informacionet lidhur me:

- individët të cilët paraqesin kërkesa për marrje informacioni apo dokumentacioni, dhënie konsulencë etj; -
- vizitorët në faqen tonë të internetit;
- aplikantët për punë, të punësuarit aktual dhe ish-punonjësit e Odës Ekonomike të Kosovës.

### ***PERSONAT TË CILËT PËRDORIN SHËRBIMET E ODËS EKONOMIKE TË KOSOVË***

Oda Ekonomike e Kosovës ofron shërbime të ndryshme për publikun. Detajet e të dhënavë të ofruara mbahen me qëllim të ofrimit të shërbimeve ndaj subjektit, kur nga ky i fundit kërkoen dhe për qëllime të tjera lidhur ngusht me kërkesat e këkruesit.

Oda Ekonomike e Kosovës çdoher kur mbledhë të dhëna personale, informon subjektin e të dhënavë për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohej të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përvèç rastit kur subjekti i të dhënavë është në dijeni të këtij informacioni.

### ***VIZITORËT NË FAQEN TONË TË INTERNETIT***

Oda Ekonomike e Kosovës disponon faqen zyrtare të institucionit me këtë adresë elektronike: <https://www.oek-kcc.org/> përmes së ciles transmeton dhe mbledh informacione.

Për vizitorët e <https://www.oek-kcc.org/> sistemi mbledh informacione standarde të cilat kanë të bëjnë me klikimet të rubrikave në këtë faqe. Ky informacion mblidhet për qëllime statistikore dhe studimi mbi përdorimin e faqes dhe shërbimeve të saj, gjithnjë pa i bërë të identifikueshëm vizitorët. Oda Ekonomike e Kosovës nuk ndërmerr asnë veprim për identifikimin e vizitorëve të faqes sonë të internetit e poashtu nuk lejon as palët e treta që përmes përdorimit të mjeteve të tilla statistikore apo analitike të mbledhë informacione personale të cilat i bëjnë të identifikueshëm vizitorët e faqes tonë zyrtare. Oda Ekonomike e Kosovës shmanq qdo lloj lidhjeje të të dhënë të grumbulluar nga kjo faqe si pjesë e përdorimit tonë me ndonjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm. Nëse përmes faqes sonë do donim të mbledhnik informacioneve të idnentifikueshme personalisht, do ju informonim paraprakisht.

### ***APLIKANTËT PËR PUNË, TË PUNËSUARIT AKTUAL DHE ISH-PUNONJËSIT E ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS***

Për rastet e punësimit nëpërmjet konkursit (sipas legjislacionit në fuqi) kandidatët kanë detyrimin të depozitojnë në institucion tonë dosjen personale me të dhënat përkatëse. Pas përfundimit të procedurës këto të dhëna administrohen nga institucioni dhe ju vihen në dispozicion subjekteve të cilët kanë të drejtë kontrolli (në rastet kur kërkohet).

Për punonjësit aktual të Odës Ekonomike të Kosovës Sektori i Burimeve Njerëzore krijon dhe administron dosjen e personelit për çdo të punësuar ku të dhënat e përfshira në të mbahen të sigurta dhe përdoren vetëm për qëllime me rëndësi të drejtpërdrejtë mbi punësimin e personit. Kur punësimi i punonjësve pranë Odës Ekonomike të Kosovës përfundon, Ne mbajmë dosjen në përputhje me legjislacionin në fuqi, ligjin për arkivat dhe aktet e brendshme normative.

### ***QASJA NË TË DHËNAT PERSONALE***

Oda Ekonomike e Kosovës është e hapur dhe u ofron individëve qasje në të dhënat e tyre personale përmes deponimit të një kërkesë për qasje në të dhënat personale, në përputhje me ligjin për "Mbrojtjen e të Dhënavë Personale".

### ***KUR NE DISPONOJMË ME TË DHËNAT E TUAJA PERONALE***

***Ne mund të ju ofrojmë:***

- një përshkrim të të dhënavë;
- informacion se përse i mbajmë të dhënat;
- informacion se tek cili marrës mund t'i përhapim këto të dhëna;
- ofojm një kopje të informacionit në një formë të kuptueshme;

Për çdo të dhënë personale që Oda Ekonomike e Kosovës mund të mbajë është e nevojshme të bëni një kërkesë me shkrim përmes zyres administrative e të drejtarit përgjegjes për Mbrojtje e të Dhënave personale. Kërkesa në parim qdo herë shqyrtohet në formë formale në afatin e paraprë ligjor (45), por nëse Oda e konsideron të arsyeshme dhe paraprakisht është e pranueshme dhe e dakorduar me palën trajtimi mund të bëhet duke iu dhënë informacionin specifik nëpërmjet telefonit. Në rast se të dhënat e mbajtura përbajnjë gabime, ju mund të kërkonit korrigimin e gabimeve në të dhënat e ofruara, duke kontaktuar edhe një here Zyrtarin përgjegjes për Mbrojtje e të Dhenave personale. Ne, afatë brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës suaj do t'ju informojmë për kryerjen apo moskryerjen e korrigjimit.

### **PERSONI KONTAKTUES**

Personi kontaktues në Odën ekonomike të Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e emëruar me vendimine Kryetarit të OEK-ut nt. prot: 514/03/2023 dt. 19.10.2023 është: Zyrtarja *Nexhmije Krasniqi* E-mail adresa: [Nexhmije.krasniqi@oek-kcc.org](mailto:Nexhmije.krasniqi@oek-kcc.org)

### **PËRHAPJA E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në shumë rrethana, Ne nuk përhapim të dhëna personale pa pëlqimin tuaj.

Ju mund të merrni më shumë informacion mbi:

- rrethanat kur ne mund të përhapim të dhënat personale pa marrë pëlqimin, për shembull
- për të parandaluar dhe zbuluar një krim dhe për të prodhuar statistika anonime; - udhëzimet për stafin se si duhen mbledhur, përdorur dhe fshirë të dhënat personale; - mënyrën si ne kontrollojmë se të dhënat që ne mbajmë janë të sakta dhe të përditësuara.

Kur kërkonit ofrimi të dhënavë në vështrim të nenit 16 Kodi të Etikes dhe Mirsjelljes Oda Ekonomike e Kosovës të dhënat/informacionet e tillë nuk i jep pa lejen e shprehur qartë të personit ose organit që i jep ato. Dhënie e informacioneve në raste të tillë lejohet vetëm atëherë kur ODA është e autorizuar të bëjë një gjë të tillë, sipas dispozitave në fuqi për sa i përket mbrojtjes së të dhënavë apo në lidhje me procedurat juridike.

Kurdo, që kontrolluesi synon të transferojë të dhëna personale të një marrës në një vend ose organizatë ndërkombëtare, këte do të bëj përmes autorizimit nga Agjencia për Informim dhe Privatësi e Republikës së Kosovës dhe duhet të informoi lidhur me ekzistencën ose mungesën e një vendimi përkatesë të Agjencisë.

## **LIDHJET ME FAQET E TJERA**

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë për të arritur mbrojtjen e të dhënave personale nuk përfshin lidhjet midis kësaj faqeje dhe faqeve të tjera.

## **ANKESA**

Çdo person i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme në lidhje me të dhënrat personale mund të parashtronë ankesë tek Agjencioni për Informim dhe Privatësi i Republikës së Kosovës.

## **POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT**

Oda Ekonomike e Kosovës përpunon informacionin me qëllim kryerjen e detyrave të saj dhe është e angazhuar për të siguruar përdorimin e informacionit dhe informacionin e sistemeve të teknologjisë me qëllim ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit nën kontrollin e saj.

Oda Ekonomike e Kosovës me qëllim të mbrojtjes së informacionit nga përdorimi i paautorizuar, ndryshimi, zbulimi apo shkatërrimi aksidental apo i qëllimshëm përdor një qasje të bazuar në risk, gjatë vlerësimit dhe të kuptuarit të rreziqeve si dhe përdor të gjitha mjetet fizike të personelit, teknike dhe procedurale për të arritur masat e duhura të sigurisë.

## **ODA EKONOMIKE E KOSOVËS**

Kryetar



Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtina – KOSOVË  
Tel: + 383 (0) 38 224 741, Tel & Fax +383 (0) 038 224 299  
[info@oek-kcc.org](mailto:info@oek-kcc.org), [www.oek-kcc.org](http://www.oek-kcc.org)